



REPUB LIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas/Gllogoc
Udhëheqësi i Personelit
01Nr. 111-26030 dt. 07.08. /2018

Bazuar në nenin 11 dhe 12, paragrafi 1.1 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenet 14,15,16 të Rregullorës Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit të Nëpunësve Civil, Komuna Gllogoc/Drenas, U.D.Udhëheqëse e Personelit shpall:

KONKURSIN PUBLIK
Për pozitën: Inspektor i Komunikacionit

Numri i kërkuar për pozitën; 1(një) Inspektor i Komunikacionit

Emri i institucionit rekrutues:	Komuna Drenas/Gllogoc
Nr. i references:	1
Pozita e punës:	Inspektor i Komunikacionit
Institucioni:	Drejtoria e Inspekcionit
Divizioni/njësia:	Sektori i Inspekcionit
Lloji i pozitës:	I Karrierës
Tipi i akt emërimit të punës:	Orar të Plotë
Pozita e punës së mbikëqyrësit:	Drejtori
Kategoria Funksionale –Grada	Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7
Mbulesë buxhetore si pas Ligjit të Buxhetit:	Po
Procedura e Aplikimit:	I Jashtëm
Numri i kërkuar:	1 punëtor/e
Kohëzgjatja e emërimit:	I përhershëm

Kategoritë funksionale dhe gradat e punës, vendndodhja e pozitave: Niveli Profesional, grada 8, Koeficienti 7 , Drejtoria e Inspekcionit, Komuna Drenas.

Detyrat Kryesore

Lejet e operimit në transportin rrugor të udhëtarëve;
Zbatimi i rendit të udhëtimit të autobusëve në linjat urbano-periferike;
Inspektimi në st.e autobusëve, parkingjet etj;
Kushtet e transportit të udhëtarve;
Evitimin e rreziqeve në rrugë;
Inspektimi i transportit të mallrave;
Kontrollimi i transportit të mallrave të rrezikshme;
Ndalimi i punës së transportuesve ilegal;
Punët dhe detyra tjera sipas urdhërit të Shefit apo Drejtorit;

Kualifikimi i nevojshëm arsimor, aftësitë specifike dhe përvoja paraprake e punës:

Diplomë Universitare, Fakulteti Teknik- Drejtimi i Komunikacionit Rrugor, Fakulteti i Inxhinierisë mekanike - Drejtimi i Komunikacionit, 3 vite përvojë pune Profesionale. Njohje kompjuterike të programeve (Word,Excel,Power Point,Access), Aftësi komunikimi me kolegët, palët, eprorët dhe rrethin, Aftësi për përmbushjen e detyrave dhe punëve nën presion.

Vendi ku mund të merren dhe të dorëzohen aplikacionet:

Në objektin e komunës, kati i parë sporteli nr.10-12, gjatë orarit të punës, Qendra për Shërbimin e Qytetarëve.

Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe dokumentet e bashkangjitura aplikacionit duhet të jenë kopje dhe nuk kthehen.

Shërbimi Civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Aplikacionit i bashkangjiten, kopje e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit për kualifikim arsimor dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme për këtë vende pune, për të cilin konkurohet.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, të mangëtat refuzohen.

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, nga dita e publikimit **07/05/2018 deri më 21/05/2018**, që konsiderohet dita e fundit e mbylljes së konkursit.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër (ngushtë) njoftohen përmes faqesë së komunës dhe shalljes në hyrje të komunës.



U.D. Udhëheqëse e Personelit

Hamumshahe Shabani